

Informator edukativ për të rinj



*Kujdes  
nga trafikimi  
njerëzor!*

---

*botues:*  
OJQ "HORIZONTI i RI"

*donator:*  
CARE International

*përgatitën:*  
Nazif Veliqi  
Indira Batriçeviq

*dizajni:*  
Omer Musliçiq

*shtypi:*  
PRESS Studio  
Ulqin

---

# Kuicides



Rreth 200,000 njerëz trafikohen ne Evropë çdo vit, pjesa më e madhe janë gra dhe vajza që detyrohen drejt prostitucionit.

Ne Evropë, vajzat dhe gratë e reja janë veçanërisht në rrezik prej kriminelëve, që iu premtojnë një punë të mirë apo studime dhe më pas e detyrojnë viktimën te prostituohet. Kriminelët përfitojnë ndërsa vajzat dhe gratë vuajnë përdhunimin, dhe dhunë fizike e psikologjike.

Trafikimi njerëzor është kaq i zakonshëm sa zë aktivitetin kriminal të tretë në renditje pas drogave dhe trafikimit të armëve.

Rreth 2 deri në 4 milion njerëz trafikohen nëpër botë çdo vit 80% e viktimave qe trafikohen në kufijtë internacional janë femra dhe 70% e tyre (femrave) trafikohen për shfrytëzim seksual.

Llogaritet qe rreth 7-13 bilion dollar janë përfitimet vjetore nga trafikimi.

*nga trafikimi njerëzor!*

# Ku'ides

2

Ky program edukativ për parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore synon që të rinjtë të ndërgjegjësohen dhe të mos mashtrohen nga premtimet joshëse, nga mundësitë e dyshimta të punësimit jashtë shtetit, të cilat mund të çojnë në shfrytëzim për lypje, shpërndarje droge, punë shtëpiake, transplantim organesh, apo prostitucion të detyruar, si rezultat i mashtrimit, paditurisë dhe mungesës së informacionit.



*nga trafikimi njerëzor!*

# Ku ides



Trafikimi i qenieve njerëzore, është një fenomen që në regjionin tonë filloi të shfaqet në fillimin e viteve 90-ta. Aspiratat e lindura për lirinë, mirëqenien dhe lëvizjen e lirë, u shfrytëzuan nga disa njerëz për të shfrytëzuar e përfituar prej të tjerëve. Duke humbur shpresën për një jetë më të mirë në vendin e vet, duke pasur vështirësi ekonomike, probleme familjare, apo mungesë informacioni, shumë gra dhe vajza filluan të largohen, duke u besuar premtimeve të bëra nga bashkëshortë të rremë për punë e kushte më të mira jetese, ose thjesht u rrëmbyen prej tyre për t'u shfrytëzuar.

*nga trafikimi njerëzor!*

# Ku'ides

4

## Çfarë është trafikimi ?

Trafikimi i fëmijëve, si dhe ai i grave dhe vajzave për shfrytëzim seksual, është një formë bashkëkohore e skllavërisë dhe përbën një shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut.

Protokolli i Palermos i vitit 2000 e cilëson trafikimin e qenieve njerëzore si:

Rekrutim, transportim, transferim, strehim ose pritje e personave, me anë të kërcënimit ose përdorimit të forcës, ose formave të tjera të detyrimit, të rrëmbimit, të dredhisë, të mashtrimit, të abuzimit të pushtetit, ose të një pozite ndjeshmërie, ose i dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve për të arritur pëlqimin e një personi, duke pasur kontrollin mbi një person tjetër, për qëllime shfrytëzimi. Shfrytëzimi përfshinë (në minimum) shfrytëzimin e të tjerëve për prostitucion, ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, punë ose shërbime të detyruara, robërim apo heqje organesh, ose praktika të ngjashme me skllavërinë.



*nga trafikimi njerëzor!*

# Kuqides



## INFORMACIONE THEMELORE

Trafikimi i qenieve njerëzore është një dukuri globale dhe konsiderohet si “Skllavëria e kohëve moderne”. Trafikimi i grave dhe vajzave nuk lidhet thjesht me prostitucionin dhe shfrytëzimin për seks, por përfshin gjithashtu shfrytëzimin e njeriut, dhunimin dhe probleme të tjera shoqërore.

Viktima të trafikimit janë kryesisht vajza dhe gra të moshës së re. Ato kanë të kaluara të ndryshme, por ajo që kanë të përbashkët është dëshira për të përmirësuar kushtet e jetesës për familjet e tyre dhe për veten. Njerëz të pamoralshëm e shfrytëzojnë këtë dëshirë të tyre për t'i bërë ato pre të dhunës më të egër që mund të ushtrohet mbi një qenie njerëzore, t'i kushtëzojnë dhe t'i detyrojnë ato të punojnë si prostituta. Viktimat e trafikimit i nënshtrohen kufizimit të lirisë, përdhunimit, dhunës fizike, psikike e ndonjëherë edhe vrasjes. Ato marrin kërcënime për veten dhe për familjet e tyre, përballen me rreziqe shëndetësore dhe rreziqe të tjera ndaj mirëqenies së tyre, duke u detyruar të praktikojnë seks të pambrojtur.

*nga trafikimi njerëzor!*

# Ku ides

6

## Trafikanti

Një person, ose një bashkësi personash, që kanë për qëllim të kryejnë, të bashkëpunojnë apo të japin pëlqimin për çdo një nga aktet që përshkruhen në trafikim.

## Person i trafikuar

Një person që është rekrutuar, transportuar, shitur, blerë, transferuar, pritur ose strehuar, siç përshkruhet në përkufizimin e trafikimit, duke përfshirë edhe një fëmijë, pavarësisht nëse fëmija ka pranuar ose jo.

## Viktima

Personat që, në mënyrë individuale ose kolektive, kanë vuajtur dëme, duke përfshirë dëmtime mendore apo fizike, vuajtje emocionale, humbje ekonomike ose një shkelje të rëndë të të drejtave të tyre themelore, përmes veprimeve ose mosveprimeve që janë në kundërshtim me ligjet në fuqi, duke përfshirë edhe ato ligje që ndalojnë abuzimin kriminal me pushtetin. *(Deklarata e Parimeve Bazë të Drejtësisë për Viktimat e Krimin dhe Abuzimit me Pushtetin, 1985)*



*nga trafikimi njerëzor!*



# Ku ides

## Ndryshimi ndërmjet Prostitucionit dhe Trafikimit

Ekziston një problem në sqarimin e pamjaftueshëm të trafikimit të grave dhe vajzave nga fenomeni i përgjithshëm i prostitucionit. Nga kjo lind nevoja për një përcaktim më të qartë dhe një njohje të elementeve që dallojnë trafikimin e grave dhe vajzave, nga fenomeni i prostitucionit.

Dhënia me dëshirë e trupit dhe e shërbimeve seksuale për një kompensim të caktuar material është një karakteristikë domethënëse në përcaktimin e ndryshimit ndërmjet këtyre dy fenomeneve.

Kjo dëshirë në prostitucion dallohet nga zotërimi i mundësive për të marrë një vendim individual për ndalimin e këtij aktiviteti nga vetë prostitutat, d.m.th. kur të dëshirojnë dhe të vendosin ato, pavarësisht nga problemet ekonomike që veprojnë mbi to.

*nga trafikimi njerëzor!*

# *Ku ides*

8

Në trafikimin e qenieve njerëzore një mundësi e tillë thjesht nuk ekziston për gratë dhe vajzat e tregtuara d.m.th. për viktimat. Ato kanë një sistem varësie të vendosur mbi to.

Ky është një sistem i tërë, i përbërë prej: kërcënimit, përdorimit të dhunës psikologjike dhe fizike, mashtrimit, shkatërrimit mendor dhe fizik, lidhjeve të borxhit dhe ngandonjëherë edhe raste vrasjeje si shembuj për të tjerat. Ky lloj sistemi e bën viktimën të paaftë të çlirojë vetveten nga ky rreth i pamëshirshëm varësie, shfrytëzimi seksual

*nga trafikimi njerëzor!*

# *Ku ides*

Ndryshe nga prostitutat që shkojnë me dëshirë, viktimat e trafikut të qenieve njerëzore d.m.th. gratë dhe vajzat e tregtuara nuk janë në gjendje të gëzojnë asnjë nga të drejtat e njeriut dhe liritë bazë të garantuara, të shprehura dhe të mbrojtura nga Ligjet vendase dhe nga Konventat Ndërkombëtare.

Viktimat e trafikimit nuk mund dhe nuk duhet të paragjyken si prostituta me dëshirë.

Konceptet e vlerësimit të ulët për viktimën e trafikimit, të menduarit se ato shkojnë me dëshirë në shtëpi publike apo trotuare, se ato marrin para etj, janë koncepte të gabuara dhe paragjyquese.

*nga trafikimi njerëzor!*

# Ku'ides

## Pse duhet te interesohesh?

Sepse...

10

Trafikimi ne njerëz është I GABUAR. Është një nga format më të tmerrshme ku shkelen te drejtat e njeriut.

Mendohej se skllavëria i takon së kaluarës. Ajo është aktuale tani dhe po ndodh këtu, atje, kudo që ti mund të ndodhesh.

- ☛ Mund të të ndodh ty apo dikujt që ti njeh. Çdo kush që mendon se do udhëtojë, punoj apo studioj jashtë vendit mund të jetë i pambrojtur.
- ☛ Ti apo njerëzit qe njeh mund të jenë duke paguar për seks; në qoftë se është kështu atëherë këto para përdoren nga kriminelët për të trafikuar dhe abuzuar femrat.

Kjo po ndodh gjithandej nëpër Evropë, pavarësisht se ku jeton.

Kjo gjithashtu mund të ndikojë edhe tek ti..



*nga trafikimi njerëzor!*

# kuides

## Studimi jashtë vendit.

Kontrollo këto pika pare se të vendosësh për të studiuar jashtë vendit.

- ☛ Kontakto universitetin apo kolegjin ku ke aplikuar për të verifikuar kurset edhe njëherë, nëse janë të vërtetë apo jo.
- ☛ Nëse ke regjistruar një kurs përmes një agjencie të pavarur, sigurohu nga burime tjera se ajo vërtetë ekziston.
- ☛ Sigurohu që ke vizën e duhur përpara se te udhëtosh. Nëse je i pasigurte se çfarë të duhet, kontakto ambasadën në fillim.
- ☛ Thuaj për kursin tënd një profesori apo prindit. Kur të shkosh në agjenci për të kryer shërbimet, merr një shok të besueshëm me vete. Nëse agjencia nuk të lejon ta vizitosh, mos u regjistro në asnjë kurs.
- ☛ Përpiqu te komunikosh me ish studentë dhe të sqarohesh për zgjedhjen që ke bërë.
- ☛ Kontakto një agjenci anti-trafikimi nëse ke dyshime (para se të udhëtosh).

*nga trafikimi njerëzor!*

# Kuides

## Rregullat për udhëtim

Këtu është një listë me këshilla përpara se ti apo dikush tjetër të largohet nga vendi i tij.

12

- Kontakto ambasadën e vendit ku po shkon dhe sigurohu për vizën e duhur që duhet të marrësh. Nëse e ke gjetur informacionin vet nga një burim zyrtar, askush tjetër nuk mund të të thotë diçka ndryshe.
- Para se të udhëtosh, fotokopjoje pasaportën dhe dokumentet e udhëtimit dhe vendosi tek dikush që i beson.
- Jepi adresën dhe nr. e telefonit shokëve dhe familjes. Merr adresën dhe nr. e telefonit të ambasadës së vendit tënd në vendin ku do shkosh.
- Jepja pasaportën vetëm policëve/zyrtarëve në doganë.
- Kontakto një organizatë anti-trafikimit nëse ke dyshime

*Pasoji këto këshilla tek shokët tuaj, nëse ato janë në të njëjtën situatë. Nuk përbën ndryshim nëse je djalë apo vajzë, e re apo e/i vjetër, çdo kush mund të jetë i rrezikuar nga trafikimi. Ruaj veten, por ruaj edhe të tjerët.*

*nga trafikimi njerëzor!*



*kuides*

12

Ti nuk je  
në je  
shitje!

*nga trafikimi njerëzor!*



*Organizata e Shoqërisë Civile*

**HORIZONTI i RI**

rr. Ymer Prizreni - Ulqin

Tel/Fax: 085/411-969

Cell: 068/300-603

E-mail: [horizon@cg.yu](mailto:horizon@cg.yu)

